

20151925266

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E
TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14, 104/15 dhe 154/15) në nenin 88-g në paragrafin (4) fjala "njëherë" zëvendësohet me fjalën "dyherë".

Në paragrafin (6) fjala "nëse" zëvendësohet me fjalët: "të paktën 30%", fjala "do" zëvendësohet me fjalët: "të", ndërsa pas fjalës "mënjanohe" shtohen fjalët: "dhe zëvendësohen me të reja".

Neni 2

Në nenin 88-d para fjalës "Profesionalë" shtohet numri "(1)", ndërsa pas fjalëve: "i kryen Drejtoria" shtohen fjalët: "për çka drejtori i Drejtorisë përcakton person përgjegjës që përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Personit përgjegjës nga paragrafi (1) i këtij neni për çdo termin mbajtur në të cilin jepet provimi i takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës së rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Drejtoria miraton vendim."

Neni 3

Në nenin 88-zh paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Neni 4

Në nenin 88-z pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Kandidatët të cilëve u është lejuar kërkesa për dhënien e provimit dhe opinioni informohen për datën dhe kohën e dhënies së provimit, të paktën tetë ditë para mbajtjes së provimit përmes ueb faqes së Drejtorisë dhe Servisit Publik Radiodifuziv."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Pas paragrafit (4) i cili bëhet paragraf (5) shtohen pesë paragrafë të rinj (6), (7), (8), (9) dhe (10), si vijon:

"(6) Përfaqësuesve nga paragrafi (5) i këtij neni për çdo termin mbajtur në të cilin jepet provimi u takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës së rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Drejtoria miraton vendim.

(7) Personi juridik i autorizuar i cili teknikisht e zbaton provimin është i obliguar ta bllokojë shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit gjatë kohës së zbatimit të terminëve në të cilat jepet provimi.

(8) Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejshëm: AKE) kryen monitorim të përhershëm të bllokimit të shtrirjes së radio frekuencës në hapësirën për dhënien e provimit, me qëllim që të pengohet çdo lloj i komunikimit elektronik me rrethin jashtë hapësirës për dhënien e provimit.

(9) AKE në hapësirën për dhënien e provimit instalon pajisje matëse që siguron incizim elektronik nga matjet e kryera në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe të njëjtat magazinohen në sistemin qendror kontrollues të AKE.

(10) AKE formon komision prej tre anëtarësh që përgatit raport në bazë të incizimeve elektronike të magazinuara në sistemin qendror kontrollues të AKE dhe të njëjtin e dorëzon te Drejtoria më së voni në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i terminit në të cilin jepet provimi."

Neni 5

Në nenin 88-x në paragrafin (3) fjalët: "paragrafi (4)" zëvendësohet me fjalët: "paragrafi (5)".

Në paragrafin (6) pas fjalës "termin" pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe i shqiptohet ndalesë për dhënien e provimit në kohëzgjatje prej tre viteve, për çka Drejtoria miraton vendim kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit."

Në paragrafin (8) fjalët: "paragrafi (4)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (5)".

Neni 6

Në nenin 88-p paragrafët (4) dhe (5) ndryshojnë si vijojnë:

"(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni mblidhet pas çdo termini të mbajtur në të cilin jepet provimi dhe kryen revizion në zbatimin e provimit, duke përfshirë edhe nëse provimin e kanë kaluar kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit në pajtim me nenin 88-a të këtij ligji, për çka dorëzon raport te drejtori i Drejtorisë.

(5) Anëtarëve të komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni u takon kompensim në para, që në nivel vjetorë arrin një rrogë mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Drejtoria miraton vendim."

Neni 7

Në nenin 95 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Me përjashtim të paragrafit (1) dhe paragrafit (2) pika 1 nga ky nen, këmbim dhe shmangie në vendin e ekzemplarëve të veçantë të mira të mbrojtura të cilat janë shpallur ose janë përfshirë në përmbledhje që janë shpallur trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë mund të kryhet me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me mendim paraprak të Drejtorisë."

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragrafi (7) fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (6)".

Paragrafi (7) bëhet paragraf (8).

Neni 8

Në nenin 119 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Procedura për ndarjen e koncesionit fillon gjashtë muaj para skadimit të koncesionit rrjedhës."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragrafi (4) fjalët: "paragrafi (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)".

Neni 9

Neni 173-b ndryshon si vijon:

"(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik të autorizuar që teknikisht e zbaton provimin nga neni 88-d paragrafi (1) i këtij ligji nëse nuk e incizon, nuk e emeton drejtpërdrejt në ueb faqen e Drejtorisë dhe nëse nuk e vendos incizimin e gjithë provimit në ueb faqen e Drejtorisë në pajtim me nenin 88-z paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar juridik që teknikisht e zbaton provimin nga neni 88-d paragrafi (1) i këtij ligji nëse nuk e bllokoi shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit në pajtim me nenin 88-z paragrafi (7) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 5.000 në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik të autorizuar nga neni 88-d paragrafi (1) i këtij ligji i cili e zbaton provimin, nëse nuk e ndërpret provimin në pajtim me nenin 88-x paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do tu shqiptohet përfaqësuesve nga neni 88-z paragrafi (5) të këtij ligji, nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 88-x paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(5) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet përfaqësuesve nga neni 88-z paragrafi (5) të këtij ligji, nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 88-x paragrafi (8) të këtij ligji.

(6) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës nga neni 88-d paragrafi (1) i këtij ligji, nëse lejon të kalojë kandidat i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara të këtij ligji.

(7) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet anëtarëve të komisionit nga neni 88-p paragrafi (3) të këtij ligji nëse përcaktojnë parregullsi në zbatimin e provimit, dhe atë nuk e konstatojnë në raportin nga neni 88-p paragrafi (4) të këtij ligji.

(8) Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kandidatit i cili vepron në kundërshtim me nenin 88-x paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(9) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet drejtorit të Drejtorisë nëse nuk e miraton vendimin në afatin e përcaktuar në nenin 88-p paragrafi (7) të këtij ligji."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".